



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 05.12.2022, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Triera Kasumi-Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Endrit Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), dhe Agim Kuleta (LB).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Arbër Vokri (LVV), Feim Osmani (LVV), Fatmir Dervishi, (PDK), Taulant Maxharraj (AAK), dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Premtime Preniqi, Koordinatorë për NJDNJBGJ, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues i Kuvendit. Para se të fillonin me pikat e rendit të ditës, kërkoj 1 minutë heshtje për rastet e fundit tragjike, si dhe për të gjitha viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Para se të fillonte mbledhja kryesuesi konstaton se ekziston kuorum për mbajtjen e kësaj mbledhje dhe propozoi këtë

Rend të ditës:

1. **Diskutim lidhur me fushatën “16 ditë aktivizim, kundër dhunës me bazë gjinore”;**
2. **Raportimi i Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje.**

Pika e parë

Diskutim lidhur me fushatën “16 ditë aktivizim, kundër dhunës me bazë gjinore”.

Violeta Salihu, përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi për përkrahje të iniciativës për këtë mbledhje. Ajo shprehi ngushëllimet për dy vrasjet e fundit të grave të cilat ndodhen në vendin tonë. Këto dy vrasje në kohën kur po flitet kudo kundër dhunës me bazë gjinore, na bëjnë që secili prej nesh të vazhdojë me përpjekjet tona edhe më fuqishëm në mënyrë që raste të tilla të mos përsëriten më. Ajo tha se fatkeqësisht kjo është një dukuri e shprehur shumë në nivelin global, që po prek të gjitha grupet shoqërore dhe se kjo lloj dhune në bazë gjinore e shprehur në mënyrë fizike ose psikologjike, cenon integritetin fizik dhe shpirtëror të viktimave. Në Komunën e Prishtinës sipas statistikave në katër vitet e fundit ka pasur një rritje të numrit të dhunës që është mjaft shqetësuese, ku brenda vitit kemi pasur një rritje rreth 30% të dhunës në familje, ndërsa vetëm nga janari 2022, deri në tetor janë raportuar gjithsej 361 raste të dhunës me bazë gjinore. Ne si Komunë përmes resurseve duhet të shikojmë mundësitë në parandalimin, intervenimin dhe ri integrimin e viktimave, ndërsa iniciativat nga Ministria e Drejtësisë për dënimet plotësuese në kodin penal, shpresojmë se që këto do të ndikojnë në uljen e rasteve të dhunës. Përfundimisht duhet ta kemi të qartë se dhuna mbi bazë gjinore nuk është një temë me të cilën duhet të merren vetëm vajzat dhe grat, por duhet të jetë një luftë e përbashkët për të gjithë.

Fehmi Kupina, kryesues tha se shumë vajza dhe gra privohen nga e drejta e trashëgimisë në pronë, e trashëgimia në pronë nuk nënkupton vetëm trashëgimi materiale, por mbi të gjitha është siguri për jetën dhe garanci për mbi jetesë. Ai kërkoj që bashkërisht të reflektojmë mbi mundësitë tona, që ti fuqizojmë të gjithë mekanizmat koordinues, lokal për mbrojtjen dhe trajtimin e gjitha viktimave të dhunës së tillë, dhe do të jemi përgjegjës për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga të gjitha format e luftës deri në ri integrimin e tyre në shoqëri.

Donjeta Sahatçiu, nënkryetare tha se që nga viti 1991, qytetet e shtetet anembanë botës u ngritën në këmbë për 16 ditë radhazi për te mbizotëruar temat ditore me diskutime, aktivitete e kampanja për rëndësinë e mbrojtjes nga dhuna ndaj grave, rëndësinë e eliminimit të dhunës me bazë gjinore.

Ky 16 ditësh në Kosovë ishte tragjik, më i zyrti që e mbajmë në mend, ku vetëm 7 ditë para këtij 16 ditëshit, ne i humbëm dy gra të vrara me dhunë në bazë gjinore, kështu që disi edhe tentuam t'i arsyetojmë vrasjet e tyre, mos ishin të sëmurë, mos ishin në vetëmbrojtje, arsyet nuk dihen ashtu na u tha, por nuk ka arsyetim për dhunën, kështu na e thotë edhe "Konventa e Stambollit".

Mbi 100 raste të ngacmimeve janë raportuar në 10 muaj. Në këtë 16 ditësh po kërkojmë të raportohet dhuna me shumë, e për te raportuar dhunën kërkohet më shumë se kurrë besim, kërkohet guxim ta lësh shtëpinë e të mendosh se nuk ke ku të kthehesh ose të paramendosh më të keqen nëse detyrohesh te kthehesh. Strehimoret i kemi të stërmbushura, shumica raste recidive, të përsëritura. Ne e heqim viktimën nga shtëpia dhe nuk e trajtojmë dhunuesin. Ne e trajtojmë viktimën dhe e kthejmë në po atë shtëpi ku edhe nuk ka ku tjetër te shkojë.

Ti fuqizojmë gratë tona ekonomikisht, ti punësojmë i fuqizojmë ato sa më shumë. Një grua e pavarur financiarisht ka mundësi më pak të jetë pre e një dhune sistematike. Ti edukojmë rrënjësisht fëmijët tanë, prindërit, po ashtu duhemi që ta trajtojmë edhe dhunuesin, të ofrojmë programe për çrregullimin e stresit post-traumatik. Të përdorim teknologjinë për më shumë raportime, qasje ne linja për këshillim dhe përmirësim të sigurisë në hapësira publike. Të blejmë byzylykë elektronik që e paralajmërojnë viktimën kur dhunuesi afrohet kur kemi urdhër mbrojtjes.

Adelina Sahiti, drejtore tha se ne sot edhe një herë tjetër të ngremë zërin e të themi që është bërë mjaftë dhuna në familje, është bërë mjaftë dhuna me bazë gjinore dhe ne po duket se po na del situata jashtë kontrollit. Ne si gra, si qytetarë, ne si politikanë do të bëjmë çdo gjë që është në dorën tonë që këtë luftë ta fitojmë, që e mira ta mbizotërojë të ligën. Por në këto "16 ditë aktivizim kundër dhunës me bazë gjinore", ne si kryeqytet po dëshmojmë dhe kemi dëshmuar që jemi pranë viktimave, dhe jo vetëm në këto por në 365 ditë të vitit, duke mbështetur strehimoret, duke ofruar një vend të sigurt të gjitha zonjave të gjitha grave të cilat përjetojnë dhunë sistematike brenda mureve të shtëpisë. I mbështesim financiarisht këto strehimore, u kemi ofruar hapësira pa pagës që ato të zhvillojnë veprimtarinë e tyre. I kemi mbështetur financiarisht këto viktimë, që ato deri në dy vite të kenë mundësi që jeta e tyre të mos jetë më e varur nga dhunuesi, ju kemi ofruar strehim e duke ofruar mjete të nevojshme për mbijetesë. Po ashtu kemi kontakte të vazhdueshme me të gjitha organizatat e shoqërisë civile, të cilat mbulojnë këtë fushë, jemi pranë viktimave në çdo formë, kemi fuqizuar qendrën për punë sociale në Komunën e Prishtinës. Pas 20 vitesh ne kemi kthyer fokusin dhe vëmendjen, duke shtuar punëtorë social çka ka qenë më se e nevojshme e që kjo nuk është bërë asnjëherë, është bërë tani.

Gëzim Sveçla tha se drejtësia është një prej hallkave të shtetit, hallka kryesore bashkë me policinë, që do të duhej të mbronte viktimën, viktimën vajzë apo grua, viktimën e mitur apo të rritur, pa dallim e pa hezitim, sipas ligjit dhe kushtetutës.

Dhuna me bazë gjinore është shumë e përhapur në Kosovë, shifrat janë alarmate, niveli i dhunës dhe rasteve të paraqitura në nivel vendi, ka një shkallë rritje mbi 10% çdo vit, në

katër vitet e fundit, ndërkohë që një e treta e këtyre rasteve ndodhin në regjionin e Prishtinës. Fatkeqësisht e dimë se prej kur ka filluar fushata “16 ditë aktivizim kundër dhunës mbi bazë gjinore”, kemi tri raste që janë rezultat i dhunës dhe një vetëvrasje të vrasësit, këto të dhëna janë shqetësuese, duhet të jetë zilja e shqetësimit shoqërorë e shtetërorë. Ne nuk guxojmë ta humbim këtë luftë, ne nuk do të dorëzohemi para dhunuesve dhe vrasësve, është hera e fundit të veprojmë, nevojitet mobilizim institucional e shoqërorë për ta luftuar këtë dukuri, është prioritet mbi prioritetet. **Amir Simnica** tha se dhuna ndaj grave dhe vajzave ka arritur një shkallë dëshpëruese në raportet e ndryshme kredibile. Zbulohet se kohët e fundit një në çdo tri gra kanë duruar dhunë fizike dhe psikologjike nga dhuna e partnerit bashkëshortit deri te ngacmimet seksuale. Kjo dhunë ndaj grave lirisht mund të quhet pandemi në hije e që duhet ndaluar. Ne duhet të marrim masa urgjente kundër kësaj dhe të garantojmë që të drejtat e grave duhet të mbrohen dhe të respektohen.

Në kohën e fundit në Kosovë është rritur dukshëm dhuna ndaj grave, madje raste të përfunduara me fatalitet. Kemi ngecur në udhëmbrojtjen për viktimën ku askush nuk e monitoron dhunuesin më pas është për qudi që ne nuk kemi pajisje elektronike që do ta monitoronin lëvizjen e secilit person dhunues ose provues të dhunimit. Një ndër hapat që duhet të ndërmerren pa humbur kohë është dhe edukimi i brezit të ardhshëm, mësimi i brezit të ardhshëm për tu dal në mbrojtje grave dhe vajzave duhet të jetë një prioritet. Gruaja është themeli i shoqërisë njerëzore, lumë ai komb që e mbështet atë.

Kumrije Shabani - Ramadani tha se dhuna ndaj grave pothuajse është e zakonshme në Kosovë, hetimet e qala dhe dënimet e buta, nëse vjen deri te një aktakuzë vështirë se kanë efekt. Gratë shpesh gjejnë ndihmë vetëm përmes OJQ-ve, dhe në strehimoret për gra, vetëm javën e kaluar janë vra dy gra në mënyrën më mizore

Në Kosovë dhuna ndaj gruas po rritet nga viti në vit, duke u nisur nga viti 2016, janë raportuar mbi 1225 raste, në vitin 2017, numri rritet për 44 raportime më shumë duke shkuar numri në 1269, në vitin 2018, numri rritet për 264 raste më shumë, në vitin 2019, numri shkon në 1914, pastaj në vitin 2020, numri i raportimeve është 1690, në vitin 2021, numri shkon në 1374, ndërsa në vitin 2022. Vetëm në 8 mujorin e fundit janë raportuar më se 2 mijë raste dhune në familje, prandaj ju sugjeroj gjitha nënat e gratë të raportojnë dhunën ndaj tyre.

Valbona Ajeti tha se dhuna mbi bazë gjinore është një fenomen i cili i shqetëson komunitetet ku jetojnë, e që ky fenomen ka pasoja të ashpra mbi viktimat por edhe në të gjithë komunitetin në periudhë afatgjatë dhe afatshkurtë. Parandalimi i dhunës në bazë gjinore lidhet fort mbi ndërgjegjësimin e shoqërisë në shoqëri, e dhuna ndaj vajzave dhe grave është një nga shkeljet më të shpeshta të drejtave të njeriut në botë. Dhuna nuk është çështje private, pasojat e saj prekin gjithë komunitetin dhe duhet të raportohen në mënyrë që ato të trajtohen, andaj raportimi me kohë në polici është shpëtim. Rekomandoj që të jetë një mekanizëm që të ofrojë këshillim telefonik, psikologjik me qëllim të fuqizimit dhe mbështetjes së këtyre grave që janë viktimat të dhunës. Uroj që raste të mos ketë fare, ndërsa mekanizmat në parandalimin dhunës të jenë gjithnjë në funksion.

Sami Boroci, fillimisht e përgëzoi inicuesen për këtë seancë të jashtëzakonshme, meqë në fund të ditës duhet të ketë karakterin e rritjes të vetëdijes të secilit prej neve për me e luftua këtë dukuri. Ka shumë faktor që ndikojnë në shfaqjen e dhunës e njëri prej tyre

është edhe problemi i shëndetit mendor e që duhet trajtuar bukur shumë. Mendoj që ne kemi pak traumë, jemi pak të dhunshëm, si shoqëri duhet trajtuar problemi që po na merr jetë njerëzish dhe po na len pasoja.

Granit Geci tha se jemi në ditët e fundit të kampanjës globale “16 ditë aktivizim kundër dhunës me bazë gjinore”, e që për simbolikë ka ditën ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave e vajzave. Kjo kampanjë ka bërë bashkë këta aktivist të mbarë globit për një kauzë të vetme për ti dhënë fund njëherë e përgjithmonë dhunës me bazë gjinore, dhunës ndaj grave.

Ju bëjë thirrje të gjithëve pa dallim ti japim fund njëherë e përgjithmonë dhunës ndaj grave, ndaj vajzave të fillojmë së pari në familjet tona, ti edukojmë fëmijët tonë me kryefjalën se gruaja dhe gratë janë pjesa më e çmueshme e shoqërisë tonë. Po ashtu ju bëjë thirrje institucioneve përkatëse dhe jo vetëm që edhe ata ta luaj rolën e tyre, të marrin përgjegjësi e të dënojmë dhunuesit. Po ashtu kërkoi nga ekzekutivi i Komunës, që viti në vijim ta gjej Kryeqytetin me kapacitete të shtuara njerëzore në kuadër të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe me hapësira të reja për gratë dhe vajzat të cilat janë viktimë e dhunës në familje.

Arianit Beqiri tha se pabarazia gjinore është e thellë dhe mund të thellohet përditë në një ambient ku pabarazia sociale është e madhe ose atëherë kur hendeku i pabarazive është më i thellë se ura e mundësive. Të drejtat, mundësit, qasja e barabartë në burime financiare, shërbime dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat janë themelet e drejtësisë sociale, pra nuk mund të kemi barazi shoqërore pa barazi gjinore. Gratë ndryshe nga burrat pikënisjen e tyre qoftë të punësimit, qoftë të angazhimit publik nuk e kanë të njëjtë, një grua ka dyfish vështirësi e barrë në angazhimin e saj publik për shoqërinë, ajo e lufton pabarazinë e përgjithshme në shoqëri edhe në atë gjinore.

Fuqizimi i grave është vendimtar për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, prandaj kur flasim për barazi duhet të flasim për mundësi të barabarta. Gratë duhet të përkrahen më shumë edhe në bursat që ndan Komuna qoftë ato shkollore por edhe ato sportive, kulturore etj. Në këtë Kuvend Komunal është dëshmuar pjesëmarrja e grave në formë aktive gjë që më bënë të ndihem mirë.

Arbnora Ajeti tha se muaji i aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore neve si shoqëri na gjen me raste të shumta të dhunës në familje, gjegjësisht dhunës ndaj grave dhe vajzave. Ne si shoqëri jemi rritur dhe zhvilluar me mentalitetin patriarkal ku siç kemi njohuri çdonjëri nga ne është përballur apo ka dëgjuar për raste dhune ndaj gjinisë femërore si në familje, në rreth, në shoqëri pra kudo.. Dhuna në familje e sidomos ndaj gjinisë femërore shpesh konsiderohet si çështje private duke aluduar se çka do që të ndodh brenda shtëpisë nuk është çështje publike. Lidhur me këtë shtoi se në kohë e fundit kemi dy raste të dhunës me fatalitet, kështu ne të gjithë duhet ta ngrisim si çështje me rëndësi të veçantë dhe të gjejmë një formë të parandalimit të këtij fenomeni me urgjencë. Ajo në vazhdim kujtoj të gjitha ato gra që kanë qenë viktimat të dhunës e që ishin: Ikballe Llalloshi 2008, Dijana Kastrati maj 2011, Antigona Morina korrik 2011, Donjeta Pajaziti nëntor 2015, Zejnepe Berisha dhjetor 2015, Dafina Zhubi shkurt 2016, Flora Olluri korrik 2016, Sevdije Berisha nëntor 2017, Valbona Ndrecaj dhe vajza e saj gusht 2018, Sabile Mavroqani korrik 2020, Sebahate Morina - Sopi mars 2021, Marigona

Osmani gusht 2021, Lirije Qerimaj janar 2022, Sanije Godanci nëntor 2022, Hamide Magashi nëntor 2022, ku secila nga këto gra janë viktime të dhunave.

Leutrim Retkoceri tha se dua ti falënderoj të gjitha ato gra që po vazhdojnë ta bëjnë betejën në jetën publike dhe ato nuk janë pak edhe brenda institucionit të Komunës së Prishtinës. Në mesin e kësaj dhimbjeje kur ne po ballafaqohemi në manifestimin "16 ditëve për të ndaluar dhunën", dhuna ndaj grave po shpërfaqet dhe çka nënkupton kjo, nënkupton se kjo është një betejë e rëndë dhe e gjatë, të cilën duhet ta bëjmë bashkërisht. Ne duhet të ngritemi si shoqëri dhe tu themi njëherë e përgjithmonë stop dhunës.

Sa më shumë pjesëmarrje e grave në jetën publike dhe politike i fuqizon gratë dhe ngrihem mbi një dhimbje që na ka goditur të gjithëve. Është emocion i papërshtueshëm këto ditë që e kemi ndjerë të gjithë, kështu që të gjithë të ngrisim zërin për të kërkuar mbështetje nga të gjitha vendet e botës për të na ndihmuar.

Pika e dytë

Raportimi i Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje

Premtime Preniqi, koordinatores për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore tha se si zyrtare për barazi gjinore jemi drejtpërdrejtë të lidhur në këtë çështje. Sa i përket pjesës së koordinimit të Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje, ju njoftoj se më 15 prill 2019, është nënshkruar marrëveshje e mirëkuptimi për institucionalizimin e Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje dhe mënyrën e funksionimit të tij në Komunë e Prishtinës. Ky mekanizëm ka për qëllim që të sigurojë një reagim të menjëhershëm dhe gjithëpërfshirës ndaj dhunës në familje, e që në këtë mekanizëm janë të involvuar të gjithë akteret kryesor të nivelit komunal të specializuar në luftimin e dhunës në familje.

Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave dhe me të drejtë konsiderohet pengesa më e madhe në realizimin e një bote paqësore, të prosperuar dhe të qëndrueshme, kështu që dhuna në thelb është çështje e pushtetit. Ajo do të përfundojë vetëm kur barazia gjinore dhe fuqizimi i plotë i grave do të behën realitet.

Gëzim Sveçla tha se shpresoj që këto raportime në të ardhmen do të jenë më të shpeshta dhe duhet të studiohen mundësitë cilat janë për ta fuqizuar më tepër këtë mekanizëm dhe që të kem një strategji konkrete si të ecet përpara në këtë drejtim.

Fiknete Bejta tha se sot këtu nga parafolësit dëgjova shumë fjalime të bukura, mirëpo nuk kemi ndoshta edhe kompetencë të marrim veprime konkrete për ta parandaluar dhunën në familje. Brenda një kohe shumë të shkurtër kanë ndodhë shumë raste të dhunës me fatalitet, prandaj është e njëjta gjë ne nuk po arrijmë ti parandalojmë rastet e dhunës para se të ndodhin.

Si Kuvend Komunal të vetmen mundësi që e kemi, jemi të ndërtojmë strategji për edukimin përmes Drejtorisë së Arsimit dhe drejtorive të tjera që mund të kenë ndërvarësi me njëra tjetrën. Të ndërtojmë strategji dhe kampanja për edukimin e brezave të ri që dhunën mos ta kenë alternativë të zgjidhjes së problemeve, prandaj në emër të GP të LDK-së kemi përgatitur disa rekomandime që do ti prezantoj Dhurata Jahaj- Retkoceri, anëtare e Komitetit për Barazi Gjinore.

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket çështjes së sigurisë në hapësirat publike do të ishte mirë që të kemi vendosje të kamerave, vendosjen e sensorve me zë dhe figurë në parqe, shtimi i numrit të psikologëve në shkolla, një strategji e re e cila që ngërthen dhunën e pastaj ndahet në nivele të tjera. Këto do të ishin disa propozime që në emër të Grupit të PDK-së dëshirojmë që të inkorporohen në rekomandim të kësaj seance.

Sami Boroci tha se do të ishte mirë që Kuvendi me e themeluar një mekanizëm ose një grup punues i përbërë prej komitetit në fjalë, prej grupeve që e mandatojnë për ta përgatitur një strategji e që këtë strategji se si Komuna i trajton këto raste, çka konkretisht mund të bëjmë në një plan pak më afatgjatë dhe çka Komuna mundet prej perspektivës së vet ti mbështes këto raste.

Donjeta Sahatçiu, nënkryetare tha se, sa për informim se ka filluar puna e përpilimit të Strategjisë lokale dhe Planit të veprimit lokal 2023/2025 për mbrojtjen kundër dhunës në familje. Ekziston strategjia kombëtare dhe e kemi të obligueshme ta adoptojmë në nivel lokal, besoj shumë shpejt do ta sjellim edhe në Kuvend si strategji.

Violeta Salihu, para të pranishme paraqiti rekomandimet si në vijim:

- Fuqizimi i Mekanizmit Koordinues kundër dhunës në familje;
- Fuqizimin e Qendrave për Punë Sociale me shtim të resurseve humane të specializuara në parandalimin, trajnimin dhe riintegrimin e viktimave të dhunës;
- Raportimi në baza 6 mujore pranë Kuvendit Komunal nga Këshilli komunal për siguri në bashkësi, Qendra për Punë Sociale dhe komandantit të stacionit policorë;
- Të rritet përkrahja financiare e strehimoreve;
- Të rritet përkrahja financiare që Drejtoria e Mirëqenies Sociale e ka filluar për gratë viktime të luftës;
- Të organizohen aktivitete të ngjashme si ajo java e gruas apo java kundër stigmës në nivelin lokal;
- Çdo 6 muaj ta kemi si pikë të rendit të ditës raportimin e situatës së dhunës nga Komiteti për Barazi Gjinore;
- Prioriteti i ndriçimit të të gjitha rrugëve dhe rrugicave në Kryeqytet;
- Realizimi i kampanjave vetëdijesuese që trajtojnë dhunën me karakter gjinor dhe familjar;
- Linja e këshillimit për personat e dhunuar, këshillim telefonik psikologjik në Komunën e Prishtinës;
- Përkrahje dhe avancim profesional, e drejta e punësimit të grave dhe vajzave të dhunuara;
- Duhet të aplikohet një formulë komunale për sigurimin e vendbanimit përmes apartamenteve që ndërtohet i dhurojnë Komunës për strehimin e grave viktime të dhunës;
- Të parandalohet braktisja e shkollës nga vajzat;
- Vendosja e kamerave të sigurisë në parqe dhe hapësira publike, sensor në parqe me zë;
- Shtimi i numrit të psikologëve.

Izet Sadiku, drejtor, propozoi që këtyre rekomandimeve ti bashkëngjitet edhe propozimi: "Të shtohet afati për aplikim të personave të dhunës seksuale në Kosovë gjatë luftës, më shumë se shkurti i vitit 2023".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 36 vota për, u miratuan Rekomandimet e prezantuara nga znj. Violeta Salihu.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina

